



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 310-18302/22

Klinë, më 01.06.2022

Duke u bazuar në vendimin e dt. 22.04.2022, Nr. 07-320-12846/22, të Kryetarit të Komunës së Klinës, ofertën publike, të publikuar më dt.11.05.2022, Nr.07-323-14922/22 dhe raportin e komisionit për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të ofruara nga ofertuesit për marr marrjen në menaxhim të vend-gjuetivë të përbashkëta Klina1 dhe Klina 2, Komuna e Klinës – Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, publikon :

NJOFTIMIN

mbi përzgjedhjen e menaxherit të vend-gjuetivë të përbashkëta Klina 1 dhe Klina 2

I. Menaxhimi i vend-gjuetivë të përbashkëta Klina 1 dhe Klina 2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 31807.50 ha dhe terrenit të gjuetisë prej 18203.55 ha, i jepet Shoqatës së Gjuhëtareve “Dukagjini” me seli në Klinë për periudhën dhjetë (10) vjeçare me qira në vlerë prej 7250,- €, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Departamenti i Pylltarisë.

Arsyetim

Komuna e Klinës – Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Gjueti, 02/L-53 dhe Udhëzimi Administrativ për Dhënien në Menaxhim të Vend-gjuetivë të Përbashkëta, Nr. 06/2009, me dt. 11.05.2022, ka publikuar ofertën publike për dhënien në menaxhim të vend-gjuetivë të përbashkëta Klina 1 dhe Klina 2.

Për t'i marr në menaxhim vend-gjuetitë e përbashkëta Klina 1 dhe Klina 2, kanë aplikuar Shoqata e Gjuhëtareve “Dukagjini”, Shoqata e Gjuhëtareve “Drenica”, D.P.Z Vali dhe D.P.H Red Bull. Komisionit për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të ofruara nga ofertuesit, pas vlerësimit dhe krahasimit të ofertave e ka rekomanduar Komuna e Klinës – DBPZHR, menaxhimin e vend-gjuetivë të përbashkëta Klina 1 dhe Klina 2, pas marrjes së pëlqimit nga MBPZHR - Departamenti i Pylltarisë, t'ia jep shoqatës së Gjuhëtareve “Dukagjini”, me seli në Klinë. Andaj, bazuar në të lartpërmendurat është vendosur si në diapozitiv të këtij njoftimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur, kundër këtij njoftim ka të drejtë të parashtron ankesë, brenda afatit prej dhjetë (10) dite nga dita e publikimit të këtij njoftimi. Ankesa i dorëzohet komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunën e Klinës



Drejtori i Drejtorisë së BPZHR

Lorene Marleku